



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1133/3 Prot.

Tiranë, më 01. 10. 2018

### V E N D I M

**Nr. 189, Datë 01. 10. 2018**

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 119, datë 13.08.2018, e A. P., kundër mjekes T. H., në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të aftësisë së kufizuar*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas pretendimeve të ankueses, më datë 06.08.2018, është paraqitur pranë Spitalit Amerikan 1, për të kryer një vizitë pranë mjekut Okulist, për djalin e saj, i cili vuan nga çrregullime të spektrit autik. Gjatë vizitës së parë, asistuar edhe nga terapistja G. V., duke qënë se djali i saj (M. P.), i ka frikë mjekët, në këtë rast reagoi mirë dhe ishte mjaft bashkëpunues.

Më pas, ankuesja është paraqitur për të vijuar vizitën me Mjekun T. H., e cila pretendohet se ka refuzuar të kryej vizitën e shtetasit M. P., duke mbajtur një qëndrim jo etik dhe aspak profesional, ndaj ankueses. Përveç kësaj, mjekja ka paralajmëruar receptionisten e Spitalit Amerikan, për largim nga puna, pasi nuk e kishte specifikuar në axhendë, që shtetasi M. P. kishte çrregullime të spektrit autik.

---

<sup>1</sup> Mbështetur në Vendimin Nr. 1198, datë 18.07.2017, shtetasi M. P., djali i ankueses, vuan nga çrregullime të spektrit autik.

Në këto kushte, ankuesja është ndier e trajtuar në mënyrë pafavorshme dhe diskriminuese nga ana e Mjekes T. H., duke refuzuar të kryej vizitën e djalit të saj me aftësi të kufizuara. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme në përpjestim me gjendjen që i ka shkaktuar asaj, duke i vendosur sanksion me gjobë.

Në këto kushte, ju njoftojmë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndjek të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për shqyrtimin e ankesave.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

1. Me shkresën me nr. 1133/1 prot., datë 15.08.2018 është njoftuar T. H. dhe i është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga pala ankuese.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës protokolluar pranë KMD<sup>3</sup>-së me Nr. 1133/2, datë 29.08.2018, Dh. H., me detyrë Drejtore e Spitalit Amerikan I, ndër të tjera sqaroi se: *“...Në emër të Spitalit Amerikan I, ju informojmë se pretendimet e shtetases, A. P., nëna e M. P. nuk qëndrojnë nisur nga procedurat që ndjek institucioni ynë dhe vëmendjes që u kushtohet pacientëve me aftësi të kufizuar. Spitali Amerikan ka si parim, mbështetjen e kauzave të tilla për fëmijët dhe këdo. Në asnjë moment nëna e pacienti, në komunikimin me telefon që ka bërë me koordinatoren e Departamentit Okulistikë, nuk ka përmendur rastin e fëmijës së saj. Punonjësja është vënë në dijeni se fëmija është autik në momentin që është paraqitur pranë ambjenteve të spitalit, recepsion. Nisur nga këto rrethana, menaxhimi i spitalit nuk kishte mundësi për të kryer vizitën sepse doktoresha T. H., kishte një ndërhyrje urgjente në sallë. Nga ana e nënës së M. P., takimi për vizitë është bërë nëpërmjet komunikimit me telefon, por nuk është lënë një vizitë fikse. Nga ana e koordinatores, pacientit nuk i është refuzuar vizita, por i është propozuar që vizita të bëhet pas sallës...”*

Lidhur me pretendimet e ngritura të ankuseses, është shprehur edhe A. D., me detyrë Koordinatore/Receptioniste e Departamentit të Okulistikës së Spitalit Amerikan I, e cila ka sqaruar se: *“Ditën e hënë me datë 06.08.2018, rreth orës 11:00, kam marrë një telefonatë nga nëna e fëmijës, M. P., e cila më ka komunikuar që ka lënë një orar vizite me mjekun okulist, por shprehet që është shumë vonë për takimin, pasi ishte në një takim tjetër vizite dhe kërkonte mundësinë për të realizuar vizitën. Pas kontrollit tek lista e rezervimeve, emri i pacientit nuk figuronte. I komunikoj zonjës që aktualisht gjendet vetëm një mjekë në departament, e cila në atë orar duhej të futej në sallë. A. P. insistoi për kryerjen e vizitës dhe paraqitet në recepsion pas një gjysëm ore së bashku me fëmijën e saj dhe fizioterapisten, duke më komunikuar që është fëmijë autik. E sqaroi edhe një herë zonjën se doktoresha T. H. duhej të futej në sallë. Sërish zonja në fjalë insiston për të realizuar vizitën. Në këto momente fizioterapistja shoqëruese, G. V., hyn në dhomë ku doktoresha po bënte kontrollat dhe sqarimet e fundit, të pacientes që do futej në sallë E. B. dhe tenton të provokojë debat. Në këto momente doktoresha, në kuadër të informimit dhe sqarimit të situatës, më thërret dhe më pyet përse dhe cili nga pjestarët e recepsionit ka lënë dy takime të mbivendosura vizitë + sallë, në të njëjtin orar. Mendoj që pyetja e doktoreshës në këtë rast ishte me karakter informativ dhe jo kërcënues, siç pretendohet nga A. P. Gjithmonë udhëzohemi që të mos lëmë orare të mbivendosura, në mënyrë që secili pacient të ketë kohën e vet. Ndodh që paraqiten në recepsion pacientë pa planifikim orari, të gjithëve u jepet mundësia të realizojnë vizitën, por duke respektuar oraret e planifikuara dhe gjithashtu oraret e sallave (salla prioritet). I komunikova*

---

<sup>3</sup> Shkurtesë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

*edhe një herë nënës së M. P., për të mos vonuar orarin e sallës së planifikuar dhe rrjedhimisht të gjitha oraret që vinin pas saj, vizitën mund ta kryente pasi dokoresha të dilte nga salla. Më komunikojnë se dëshirojmë të lënë një takim tjetër, pasi fëmija nuk pret dotë. Si pacienti M. P., ishin të pranishëm pacientë të tjerë, të cilët duke kuptuar drejt prioritetin që ka pacienti për operacion, pritën derisa mbaroi procedura kirurgjikale dhe realizuan vizitën në mënyrë korrekte. Kjo vërtetohet edhe nga tabela appointments/takimet e printuar, të orareve të datës 06.08.2018, ku duken që vizitat janë kryer deri në 12:00 dhe midis orës 12:00-14:00, nuk ka orare pasi dokoresha u fut në sallën e operacionit për të operuar pacienten E. B. Siç duket nga tabela e vizitave, ato kanë rifilluar pas orës 14:30. Gjykoj që nuk kemi të bëjmë me asnjë veprim diskriminues nga ana jonë dhe nuk ka pasur refuzim të vizitës nga ana e dokoreshës, por vetëm kërkesë për të pritur dhe kryer vizitën e operacionit. Gjithashtu, dëshiroj të shtoj se gjatë 5 viteve punë pranë Spitalit Amerikan I, Departamenti i Okulistikës, së bashku me T. H., kemi trajtuar shumë raste të fëmijëve me aftësi të kufizuara apo shtresave në nevojë, ndaj së cilës T. H. ka ofruar dhe shërbim falas kur i është kërkuar dhe nuk kam vënë re asnjë shenjë diskriminimi ose paragjykimi nga ana e saj, por përkundrazi një impenjim maksimal human dhe profesional, për t'i ndihmuar të gjithë njëjloj. Bazuar në këto, shpreh mendimin tim që pretendimet e zonjës A. P. për sjellje diskriminuese të T. H., ndaj fëmijës së saj autik nuk qëndrojnë, aq më tepër që zonja në fjalë nuk pati asnjë kontakt me dokoreshën.”*

Në përgjigje të kërkesës për informacion të KMD-së, T. H. u shpreh se: “...Nuk ka pasur refuzim në lidhje me kryerjen e vizitës së shtetasit M. P. dhe aq më tepër refuzim për shkak të çrregullimeve të spektrit autik siç pretendohet. Pacienti së bashku me familjarët dhe fizioterapisten, janë paraqitur më datë 06.08.2018, pranë klinikës së syve të Spitalit Amerikan I, rreth mesditës, në momentet e ngarkesës me pacientë, duke insistuar se ka lënë orar takimi me mjekun okulist dhe duke pranuar se ishte me vonesë, për arsye se kishte qënë në vizitë diku tjetër (bashkëngjitur deklaratën e recepsionistes e detajuar për këtë fakt). Emri i pacientit nuk figuronte në listën e orareve vizita /operacione të planifikuara për tu kryer atë ditë. Familjarët janë pritur dhe sqaruar nga recepsionistja...Mendoj se pretendimi i ankueses për trajtim në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese nuk qëndron. Gjatë viteve të punës si mjekë okuliste kam trajtuar dhe ndihmuar shumë pacientë, fëmijë dhe të rritur, me patologji të ndryshme të syrit, si dhe sëmundje/çrregullime bashkëshoqëruese. Në asnjë rast të vetëm nuk kam bërë dallime apo diskriminime, por kam dhënë ndihmesën time profesionale aty ku më është kërkuar, pa asnjë paragjykim. Duhet të pranoj se jam prekur nga akuzat e rënda që A. P. ka hedhur në drejtimin tim, aq më tepër duke pasur parasysh se personalisht nuk jemi takuar atë ditë as me të, dhe as me fëmijën M. P.”

Pësa i përket çështjes në fjalë, me anë të një deklaratë datë 20.08.2018, është shprehur edhe E. B., e cila ka sqaruar ndër të tjera se: “...ditën e hënë, më datë 06.08.2018, jam paraqitur pranë Spitalit

*Amerikan I, sepse kisha një ndërhyrje të planifikuar. Vizita ishte kryer disa ditë më parë nga T. H. dhe në bazë të kërkesës time, ishte përcaktuar dita e hënë si ditë e ndërhyrjes kirurgjikale. U paraqita pranë këtij Spitali ditën e hënë dt. 06.08.2018, në orarin e njoftuar në telefon nga recepsionistja. Mu shpjegua se paraqitja në spital duhej bërë 1 orë përpara operacionit... Në momentin që bëmë fotografitë e syrit, para ndërhyrjes dhe doktoresha po më shpjegonte me qetësi procedurën e ndërhyrjes si dhe po i përgjigjej me shumë korrektësi të gjitha pyetjeve të mija, të cilat mendoj se janë normale që çdo pacient ka përpara operacionit. Në këtë moment, hyn në dhomë një zonjë me flokë të shkurtra, për të cilën na u tha nga recepsionistja, se ishte fizioterapistja shoqëruese e një pacienti autik, e cila me një fjalor jo shumë etik u mundua të provokonte debat me doktoreshën. Në prezencën time, T. H. i shpjegoi se po mundohej ti përgjigjej me korrektesë të gjithë pacientëve të planifikuar dhe iu lut të respektonte praninë time si pacient të planifikuar për tu futur në sallën e operacionit. Gruaja u largua duke përdorur fjalë ofenduese në drejtim të T. H. Duke qënë prezente në momentin e debatit, që zonja deshi të provokonte, deklaroi me përgjegjësi të plotë, se në gjykimin tim T. H., nuk ka kryer asnjë veprim diskriminues, kundrejt asnjë pacienti në situatën në fjalë, përkundrazi, ishte impenjuar në maksimum, për të zgjidhur ngarkesën e pacientëve dhe sidomos për të respektuar orarin e operacionit. Duke folur nga situata e pacientit që isha në pritje për të hyrë në sallë dhe çdo minut më dukej orë, e gjykoj mjaft profesionale sjelljen e doktoreshës. Mënyra e trajtimit tim nga ana e T. H., si para, gjatë dhe në periudhën post operatore, ka qënë mëse e lavdërueshme, si nga ana profesionale, ashtu edhe nga ana mjekësore.”*

Bashkëngjitur deklaratave të përfaqësuesve të Spitalit Amerikan I, është vënë në dispozicion edhe deklarata e I. H., në cilësinë e themeluesit të Fondacionit “Dhuro Dashuri”, i cili ndër të tjera ka sqaruar se: “...Gjatë shoqërimit të pacientëve për të realizuar trajtimet në klinikën e Okulistikës të Spitalit Amerikan, kam pasur rastin të asistoj shpesh herë në vizitat e kryera nga T. H. Gjatë këtyre vizitave kam vënë re një përkushtim maksimal nga ana e doktoreshës, për të ndihmuar pacientët në nevojë dhe më ka bërë përshtypje vëmendja, profesionalizmi dhe përkujdesja që ajo i kushton secilit pacient, pa dallim apo paragjykim... Ne jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me T. H. dhe të gjithë pacientët shprehen të kënaqur nga shërbimi dhe sjellja e doktoreshës...”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

## **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.**

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, A. P., së bashku me djalin e saj dhe terapisten G. V., më datë 06.08.2018, janë paraqitur pranë Spitalit Amerikan 1, për të kryer një vizitë pranë mjekut Okulist, për djalin e saj, i cili vuan nga çrregullime të spektrit autik. Referuar deklaratave të dhëna nga palët, rezulton që gjatë kohës që ankuesja është paraqitur për të kryer vizitën pranë Departamentit të Okulistikës, oraret e vizitave ishin të rezervuara nga pacient të ndryshëm. Në orarin që ankuesja është paraqitur pranë Spitalit Amerikan, mjekja T. H., ka patur të përcaktuar realizimin e një ndërhyrje kirurgjikale ndaj një patienti. Megjithatë, nga ana e përfaqësuesve të Spitalit Amerikan, i është ofruar mundësia që pas përfundimit të ndërhyrjes kirurgjikale të mund të realizojë vizitën me mjeken okuliste.

Mbështetur në verifikimin e tabelës së planifikimeve të vizitave të datës 06.08.2018 në Departamentin e Okulistikës dhe referuar listës së takimeve të caktuara, për kryerjen e vizitave me mjeken T. H., rezulton që emri i ankuseses apo i djalit të saj, nuk figuron të jetë i cituar. Pra, konstatohet se nuk është lënë apo rezervuar një takim për të kryer vizitën tek mjeku okulist i Spitalit Amerikan I.

Nga verifikimi i listës së takimeve, vizitave dhe operacioneve të kryera gjatë datës 06.08.2018, nga mjekja T. H., rezulton që në orën 12:00-14:00, ishte caktuar ndërhyrje kirurgjikale ndaj E. B. Nga informacioni i dhënë nga pacientja E. B., gjatë kohës që ajo ka qënë duke kryer vizitën me mjeken T. H., ka hyrë në dhomën e vizitave G. V. dhe ka kërkuar me insistim të realizojë vizitën e shtetasit M. P.. Në kushtet që nuk kanë qënë e mundur në atë moment, nga mjekja nuk është marrë përsipër të realizojë vizitën jashtë orareve të përcaktuara më parë me pacientët.

Pavarësisht pretendimeve të ngritura nga ankuesja, nuk rezulton i provuar fakti se T. H. të ketë kryer një sjellje të pafavorshme dhe diskriminuese ndaj saj. Nga sa rezulton nga provat e administruara, konstatohet se ankuesja nuk ka rezervuar më parë një takim me mjekun okulist të Spitalit Amerikan dhe në këtë situatë nuk ka qënë e mundur që djali i saj t'i nënshtrohej një vizite nga mjeku okulist, pa respektuar oraret e përcaktuara më parë të vizitave.

**Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk arriti të administrojë prova dhe fakte me anë të të cilave të vërtetojë pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, për trajtim të pafavorshëm dhe diskriminues nga ana e mjekes T. H.**

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të A. P., nga ana e mjekes T. H., për shkak të aftësisë së kufizuar të djalit të saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

---

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësisë së kufizuar)

(Fusha: Shërbime)